

Njoftim për shtyp

Takimi i Komitetit të Drejtorëve Politikë Takimi i Grupit Ad-Hoc të Grupit të Punës për të ardhmen e SEECP-së

Tiranë 5-6 nëntor, 2014

Në datat 5-6 nëntor 2014, në kuadër të aktiviteteve të Kryesisë Shqiptare të Procesit të Bashkëpunimit të Vendeve të Evropës Juglindore (SEECP), u zhvilluan në Tiranë: Takimi i Komitetit të Drejtorëve Politikë të vendeve pjesëmarrëse, Takimi i Grupit Ad-Hoc të Punës të SEECP, lidhur me të ardhmen e këtij forumi, si dhe takimi i Trojkës së SEECP-së, me pjesëmarrjen e Kryesisë Shqiptare, Rumune dhe Bullgare. Në takime morën pjesë përfaqësues të të gjitha vendeve pjesëmarrëse si dhe të ftuar nga Presidenca Italiane e Këshillit të BE-së, të Komisionit Europian, të European External Action Service (EEAS) dhe të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Takimin e Drejtorëve e përshëndeti Drejtori i Përgjithshëm i Marrëdhënieve Dypalëshe në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, z. Sokol Gjoka.



Gjatë mbledhjes pjesëmarrësit shkëmbyen pikëpamje lidhur me situatën në rajonin e Evropës Juglindore, përqendruar në bashkëpunimin rajonal si dhe shprehën vlerësime lidhur me prioritetet dhe aktivitetet e parashikuara gjatë Kryesisë Shqiptare.

Pothuaj të gjithë diskutantët nënvizuan rëndësinë e SEECP-së si forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit politik në rajonin tonë dhe theksuan që marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, thellimi i vazhdueshëm i tyre, si në nivelin dypalësh ashtu edhe atë shumëpalësh, mbeten të qenësishme për të realizuar progresin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit.

Në diskutime u theksua që përafrimi dhe ankorimi i rajonit në rrjedhat integruese Euro-atlantike, mbetet forca më e rëndësishme shtytëse e procesit të bashkëpunimit rajonal. Në këtë kontekst, gjatë diskutimeve u theksua se, stadi aktual i bashkëpunimit në rajon kërkon unifikimin dhe forcimin e zërit tonë të përbashkët, për ta konkretizuar këtë bashkëpunim përmes projekteve dhe aktiviteteve që synojnë rezultate të prekëshme e të qëndrueshme për të gjitha shoqëritë tona. Në këtë kontekst u vlerësua kalendari i aktiviteteve të Kryesisë Shqiptare si kontribut konkret që thëllon bashkëpunimin rajonal në fushat dhe sektorët më të rëndësishëm.

Takimi i Grupit Ad-hoc të Punës shërbeu për shkëmbimin e mendimeve dhe pikëpamjeve të pjesëmarrësve rreth çështjeve që kanë të bëjnë me përshtatjen e këtij



forumi me dinamikat dhe kërkesat e reja që shtron stadi i arritur i bashkëpunimit rajonal.

Konkretisht u diskutua lidhur me: rritjen e vizibilitetit të SEECP-së në arenën ndërkombëtare, veçanërisht në strukturat e BE-së dhe të NATO-s, forcimin dhe përmirësimin e mirëfunksionimit të kësaj nisme si forumi më i rëndësishëm politik i rajonit, rritjen e

bashkëpunimit dhe të koordinimit midis SEECP-së dhe RCC-së si krahu operativ i SEECP-së, si dhe sigurimin e vazhdueshmërisë së prioriteteve dhe koordinimin e aktiviteteve ndërmjet kryesive, veçanërisht në kuadër të trojkës së procesit, etj.